



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-100

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/49
PËR PATENTIM**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (ç) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke pasur parasysh nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/49 për Patentim për krijimin e kushteve që Ligji të gjejë zbatueshmëri të plotë,

Miraton:

**LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/49
PËR PATENTIM**

Neni 1

Në Ligjin për Patentim Nr. 2004/49 të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/56 të datës 21.12.2004 në nenin 13.1 në reshtin e parë fshihet fjalia “Agjencia e Pavarur brenda Qeverisë” dhe zëvendësohet me “Zyrë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë”.

Neni 2

Në nenin 13.3 në reshtin e parë fshihet fjalia “Qeveria” dhe zëvendësohet me “Ministria e Tregtisë dhe Industrisë”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-100
18 dhjetor 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha